



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Nr. 68/18

Datë: 16.10.2018

Në mbështetje të nenit 28, 34, 35, 36, 38 dhe 54, paragrafi (2) nën paragrafin 2.1, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25) dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, duke pasur parasysh kërkesën e Kujtesa Net Sh.p.k. dhe IPKO Telecommunication L.L.C., ka të bëjë vlerësimin e objektit të *kontratës* e lidhur ndërmjet Telekomit i Kosovës Sh.a me Ministrinë e Administratës Publike dhe MFSK-së andaj Komisioni i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datën, 16.10.2018 merr këtë:

**KONKLUZION**

për

- I. Fillimin e procedurës ndaj Telekomit të Kosovës Sh.A, Adresa: Dardani PN, 10000, Prishtinë, Kosovë Nr. i regjistrimit: 70280741;  
Ministrisë së Administratës Publike (MAP) Adresa: ndërtesa e ish-Rilindjes, Kati III zrya Nr. 303, 10000 Prishtinë, Kosovë nr. i regjistrimit: 90000136; dhe  
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Adresa: objekti i MFSK-së, Kazerma “Adem Jashari” PN, 10000 Prishtinë, Kosovë Nr. i regjistrimit: 94000050;  
- për të vlerësuar Kontratën Publike Kornizë Nr. 01-1277/17, e datës 29 mars 2017, lidhur mes Ministrisë së Administratës Publike dhe Telekomit i Kosovës Sh.a, për Shërbime Telefonike Mobile, Internet, GRPS, Kabllor Optik, Shërbimet e Telefonisë Fikse dhe Shërbimet e TV Kabllore, dhe Marrëveshjen e datës 09.06.2015, me Nr. 01-1277/17, e lidhur ndërmjet Telekomit të Kosovës Sh.a dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, “Furnizimi me Shërbimet e Internetit dhe Televizionit Kabllor” për nevojat e FSK-së dhe MFSK-së.
- II. Autoriteti, kërkon nga Telekomit i Kosovës Sh.a., Ministria e Administratës Publike dhe Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës që t’i ofrojë të gjitha informatat e nevojshme lidhur me procesin e nënshkrimit të Kontratave/Marrëveshjeve si dhe bazën ligjore të tyre të cekura në pikën (I) të këtij dispozitivi.
- III. Autoriteti kërkon nga MAP-i të ofrojë komentet ose shpjegimet rreth përfitmeve nga këto marrëveshje/kontrata të lidhura me Telekomin e Kosovës Sh.a.
- IV. Palët janë të detyruar që në afat prej tridhjet (30) ditësh të ia ofrojë Autoritetit dokumentet e kërkuara si në pikën II (Dy) të këtij dispozitivi.
- V. Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

## ARSYETIM

---

1. Iniciativa për të filluar procedurën e cila është kompetencë e Autoritetit, kërkesën, propozimin, kundërshtimin ose ndonjë paraqitje tjetër në formë të shkruar, mund ta paraqesë çdo person fizik apo juridik, shoqatë profesionale ose ekonomike e interesit, oda ekonomike, shoqatat e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, organet e administratës publike, qendrore dhe ato lokale.
2. OE Kujtesa Net Sh.p.k, dhe IPKO Telecommunications LL.C, kanë pretenduar se marrëveshjet e cekura më lartë shkelin Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Nenit 4. Paragrafët 1.2, 1.3, 1.4, Nenin 11 paragrafët 1.2, 1.3 dhe 1.5.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ofruar nga paraqitësit e kërkesës paraprakisht shprehim se marrëveshjet në fjalë sipas pretendimeve të paraqitësve të kërkesës, aludohet se ka si **objekt dhe pasojë** kufizime të konkurrencës, ndërsa për t'i sqaruar të gjitha këto pretendime Autoriteti duhet që të sigurojë dhe të konsultojë klauzolat e Kontratave/Marrëveshjeve.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës nuk është e lejuar ankesa dhe nuk është e lejuar padia për inicimin e konfliktit administrativ.

(\_\_\_\_\_)  
Valon Prestreshi  
Kryetari i AKK-së

(\_\_\_\_\_) (\_\_\_\_\_) (\_\_\_\_\_) (\_\_\_\_\_)  
Ahmet KRASNIQI Fatime S. HAZIRI Muhamed KRASNIQI Shaqir MORINA  
Zv. Kryetar Anëtare Anëtar Anëtar

Me këtë Konkluzion të njoftohen:

- *Ministria e Administratës Publike (MAP)*
- *Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK)*
- *Telekomi i Kosovës Sh.a.*
- *Arkiva*